



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE

Nr. _____ prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2026

NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri: Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike

Adresa: Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2

Tel/Faks: 083222222

E-mail: NMIPP@hotmail.com

Adresa e ueb-faqes: <https://bashkiapogradec.gov.al/>

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri E.Çela

E-mail erjola.cela@bashkiapogradec.gov.al

3. Lloji i procedurës së prokurimit: "Procedura e hapur e thjeshtuar-mallra-elektronike"

4. Lloji i kontratës /Marreveshjes Kuader: Kontratë malli

5. Numri i referencës për procedurën/Lotin: REF-80913-04-03-2026

6. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër: "Makine Pirun".

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):

Kamionë ngritës pirun 42415110-2

Kamionë ngritës pirun, kamionë pune, traktorë platforma hekurudhore 42415000-8

8. Fondi limit total: 3,330,000 (tre milion e treqind e tridhjetë mijë) lekë pa TVSH.

9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit: Ndryshimi i dokumentave të tenderit do të bëhet pas rekomandimeve të dhena nga APP.

10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar:

Afati i ri për pranimin e ofertave: Date: 24/04/2026 / Ora 10:00.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Enton BERBERI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE

Nr. ____ prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2026

SHTOJCE MODIFIKIMI

Lënda: Modifikimi i dokumentave të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt:

“Makine Pirun”

Autoriteti Kontraktor **NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE**, ju bën me dije për modifikimet e DT, të publikuara në www.app.gov.al, për procedurën e prokurimit me objekt: “Makine Pirun” me fond limit total: **3,330,000** (tre milion e treqind e tridhjetë mijë) **lekë pa TVSH**, me nr.REF-80913-04-03-2026 parashikuar për tu zhvilluar me date: 17.04.2026 Ora: 10:00. Autoriteti kontraktor **NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE**, në mbështetje të nenit 75 e në vijim të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar dhe rekomandimeve të APP ju bën me dije për modifikimin e dokumentave standarte të tenderit (kriteret e veçanta të kualifikimit), dhe shtyrjen e datës së pranimit dhe hapjes së ofertave të përcaktuara në DT, të publikuara në www.app.gov.al.

ISHTE

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*
- Formularin e Ofertes.*

BEHET

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

ISHTE

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2025 sipas afateve të përcaktuara në ligjin 9632/2006 “Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kësaj deklaratë duhet të bashkëngjiten të gjithë vertetimet që deshmojnë se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet perkatese**, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për këto periudhe.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

BEHET

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për **këstet e maturuara të vitit 2026** sipas afateve të percaktuara në ligjin 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Kësaj deklaratë duhet ti bashkëngjiten të gjithë vertetimet që deshmojnë se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet perkatese**, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për këtë periudhë.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

ISHTE

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

BEHET

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të

legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara**, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara,

- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara**, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e mallrave të furnizuara.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës, në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, te ndryshuar si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar.

Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja per automjetin e kerkuar nga AK si dhe nga problematikat dhe nevojat qe lindin ne terren per AK.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Afati i ri për pranimin e ofertave: Date: 24/04/2026 / Ora 10:00.

Njesia e Prokurimit

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ENTON BERBERI